

**AKT THEMELIMI**  
**I**  
**SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“MD green energy” SHPK**

Ortakët themelues si më poshtë:

- Shoqëria “**DABAR**” SHPK, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NIPT L62409033I, me zyrë qendore në Tiranë, Kashar, MEZEZ, Autostrada Tiranë - Durrës, km 5, zonë kadastrale nr. 2679, e përfaqësuar nga Reni Metaliaj, i biri i Azemit, i datëlindjes 25.03.1990, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal J00325093A;
- Shoqëria “**I.D.K - KONSTRUKSION**” SHPK, regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) me NIPT K51408016J, me zyrë qendore në Tiranë, Vorë Autostrada Tirane-Durrës, Km.12, Rruga Zaja, Kodër Berxullë, Nr.Pasurie 1014/3, ZK.1167, e përfaqësuar nga Gramos Dalipi, i biri i Barjamit, i datëlindjes 12.05.1972, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H20512238U;

bazuar në Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar), Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 15.03.2022, hartojnë këtë Akt Themelimi të shoqërisë si më poshtë vijon;

**NENI 1**  
***Emri***

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar mban emrin “**MD green energy**”. Ndryshimi i emërimit të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 2**  
***Forma***

Shoqëria tregtare “**MD green energy**”, ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar.

**NENI 3**  
***Zyra Qendrore***

3.1 Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar “**MD green energy**” SHPK, do të ketë zyrën e saj qendrore në adresën Tiranë, Kashar, MEZEZ, Autostrada Tiranë - Durrës, km 5, zonë kadastrale nr. 2679.

3.2 Ndryshimi i zyrës qendrore të shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 4**  
***Objekti i Veprimtarisë***

Objekt i veprimtarisë së shoqërisë është:

- a) Prodhim të energjisë elektrike, duke shfrytëzuar burimet e energjisë, të cilat gjenden në natyrë dhe janë të rinovueshme, si ajo hidrike, diellore, e erës, gjeotermale, e biomasës ose bogazit, si dhe energjia nga mbetjet urbane.



- b) Studim dhe projektim të hidrocentraleve, centraleve apo impianteve të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjisë që gjendet në natyrë dhe që janë të rinovueshme
- c) Ndërtim, rehabilitim, modernizim të hidrocentraleve, të centraleve dhe të impianteve, të cilat bëjnë të mundur shfrytëzimin e energjive që gjenden në natyrë dhe që janë të rinovueshme.
- d) Operim, shitje të energjisë elektrike klientëve dhe blerje të energjisë elektrike nga operatorë të ndryshëm privat apo shtetëror, brenda dhe jashtë vendit.
- e) Transmetim të energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfshin edhe transmetimin ose interkonjeksionin ndërkombëtar.
- f) Përdorim të sistemeve të linjave, strukturave mbështetëse dhe pajisjeve transformuese e kontrolluese për transmetimin e energjisë elektrike.
- g) Operim në sistemin e transmetimit për të kryer aktivitetin e transmetimit të energjisë dhe të dispeçerimit (axhustim ose rregullim i prodhimit) të energjisë elektrike, sipas kërkesave të konsumit në nivel kombëtar.
- h) Shpërndarjen, transportin e energjisë elektrike në sistemet shpërndarëse të tensionit të mesëm dhe të ulët, duke pasur parasysh shpërndarjen deri tek konsumatori i fundit.
- i) Import-Eksport të pajisjeve dhe materialeve elektrike.

Shoqëria, në mënyre dytësore dhe vetëm me qëllim zhvillimin dhe realizimin e objektit të veprimtarisë së shoqërisë, mund të kryejë aktivitete tregtare, industriale, finansiare, shit-bletje të pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme; shoqëria, mund të marrë pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë në shoqëri të tjera, në ente apo grupe shoqërishe, që kanë objekt veprimarie të ngjashme, ose të lidhur me të.

Shoqëria ka të drejtë të ushtrojë çfarëdolloj veprimtarie tjetër të lejuar nga ligji dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

#### NENI 5 *Kohëzgjatja*

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj për një periudhë të pacaktuar.

#### NENI 6 *Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit*

Shoqëria tregtare “MD green energy” SHPK mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë vendit.

#### NENI 7 *Përgjegjësia e Ortakëve*

Ortakët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë “MD green energy” SHPK dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara prej tyre.

#### NENI 8 *Kapitali i Regjistruar dhe Kuotat*

8.1 Kapitali i regjistruar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “MD green energy” SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i cili është nënshkruar dhe derdhur rregullisht nga të gjithë ortakët.

8.2 Ortakët kanë kontribuar në krijimin e kapitalit të shoqërisë dhe zotërojnë kuotat e tyre në këtë mënyrë:

- Shoqëria “DABAR” SHPK, zotëron një kuotë të kapitalit me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50% (pesëdhjetë për qind) në kapitalin e shoqërisë;
- Shoqëria I.D.K - KONSTRUKSION” SHPK, zotëron një kuotë të kapitalit me vlerë nominale 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë, e cila përfaqëson një pjesëmarrje prej 50% (pesëdhjetë për qind) në kapitalin e shoqërisë;

**NENI 9**  
***Organet e Shoqërisë***

Organet drejtuese të shoqërisë janë:

- Asambleja e Përgjithshme
- Administratori

Detyrat e organeve të shoqërisë do të përcaktohen në statutin e shoqërisë.

**NENI 10**  
***Administratori***

Shoqëria administrohet nga një administrator që emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Afati i emërimit është 2 vjet me të drejtë ripërtëritje. Administrator i Shoqërisë është z.Sulejman Margjeka mbajtës i letërnjoftimit me numër personal H60623094L;

**NENI 11**  
***Sekreti tregtar***

Ortakët, administratori dhe punëmarrësit e shoqërisë “MD green energy” SHPK përgjigjen ndaj shoqërisë për dëmin e shkaktuar nga përhapja e sekreteve tregtare, për të cilat kanë dijeni, për shkak të kryerjes së funksioneve të tyre në shoqëri.

**NENI 12**

Të gjitha mosmarrëveshjet midis ortakëve duhet të zgjidhen me mirëkuptim. Në rastet kur ato nuk mund të zgjidhen me mirëkuptim secili prej ortakëve ka të drejtë t’i drejtohet për zgjidhje Gjykatës kompetente.

***Ky Akt Themelimi përpilohet në 3 (tre) origjinale secili me të njëjtën vlerë ligjore***

**ORTAKËT THEMELUES**

Shoqëria “DABAR” SHPK  
përfaqësuar nga

**RENI METALIAJ**

*Reni Metaliaj*



Shoqëria I.D.K - KONSTRUKSION” SHPK  
përfaqësuar nga

**GRAMOS DALIPI**

*Gramos*

